



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2018:032784

Datë: 05.03.2021

Numri i dokumentit: 01571923

P.nr.54/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për krime të rënda, në trupin gjykues të përbër nga gjyqtaret profesionist: Violeta Husaj Rugova kryetare e trupit gjykues, Sami Sharraxhiu dhe Veton Ademaj anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Bute Ramosaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarit B. Q. nga fshati, Komuna, për veprë penale, “Grabitje në tentativë” nga neni 329 par.3 lidhur me neni 28 të KPRK-së, dhe për veprë penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armës nga neni 374 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për krime të rënda PP/I.nr.346/15 të datës 03.03.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në prezencë të Prokurorit të shtetit Sahide Gashi, të akuzuarit B. Q. dhe mbrojtësi i tij sipas autorizimit, av. I. O., i dëmtuari B. J. me datë 22.02.2021 mori dhe shpalli, si dhe me datë 05.03.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

B. Q., i biri i H. dhe nënës D. e gjinisë T., i lindur me datë në, tani me banim në fshatin, Komuna, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. personal, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

I. Me datë 30.11.2015, rreth orës 23:45, në fshatin, Komuna, me qëllim të përvetësimit të dobisë pasurore të luajtshme nga personi tjetër, pas marrëveshjes paraprake me të pandehurin A. dhe pas lajmërimit nga ky i fundit se po nisen së bashku me të dëmtuarin B. J. për në drejtim të fshatiti pandehuri B. fillimisht në rrugë vendosë pengesa me gurë dhe pasi vëren automjetin e të dëmtuarit, shtënë me armë në drejtim të saj, me qëllim që ta ndalojë të dëmtuarin dhe nga i njëjti ti merr të hollat e pazarit në shumë prej mbi 5.000€, mirëpo i dëmtuari arrin ti kalojë pengesa dhe të largohet nga vendi i ngjarjes,

-Me çka ka kryer veprën penale “Grabitje në tentativë” nga neni 329 par.3 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

II-Me datë 30.11.2015, rreth orës 23:45, në fshatin, K, ka mbajtur në pronësi armë, pa leje të organeve kompetente, në atë mënyrë që pas rastit të tentimit të grabitjes nga ana e të pandehurit, me rastin e arrestimit të të njëjtit, i gjejnë dhe konfiskohet armën e zjarrit konkretisht – një pistoletë M- 57 kalibrit 7.62 x 25 mm, Zastava prodhim Jugosllav me nr. serik 208520 m, një karikator i zbrazet, një fishek i kalibrit 7.9 mm një fishekë i kalibrit 9x19 mm.

-Me çka ka krye veprën penale – mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armës nga neni 374 par 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e neneve 7, 17, 21 par. 2, 45 par. 2, 46, 62, 69, 73, 74, 75 par. 1 pika 1.1, 1.2, 1.3, 83 par. 1 neni 329 par. 1 dhe 3 lidhur me 28, neni 374 par. 1 dhe 3 të KPRK-së, si dhe neneve 365, 366, 367 par. 1 pika 1.1 të akuzuarin e :

G J Y K O N

1. Për veprën e parë penale si në dispozitivin e I të cekur më lartë i përcaktohet dënimi me gjobë në shumë prej 300€ (treqind euro) dhe dënimi me burg me kohëzgjatje prej 3 (tri) vite, në të cilin dënimi do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 01.12.2015 e gjere me datë 30.06.2016, si dhe koha e kaluar në paraburgim nga data 01.03.2020 e tutje.

2. Për veprën e dyte penale si në dispozitivin II të cekur më lartë i përcaktohet dënimi me të holla në shumë prej 1.000€ (njëmijë euro).

Konform neni 80 par. 1 të KPRK-se, caktohet dënimi unik me gjobë në shumë prej 1.300€ (një mijë e treqind euro), e të cilin dënimi obligohet që ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Nëse dënimi unik me gjobë të cekur si më lart nuk e paguan në afat të caktuar atëherë i njëjti do të shndërrohet me dënimi me burg, duke ju llogaritur një ditë burg për çdo 20 € të gjobës.

I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor gjykatës të ia paguaj shumën prej 100€ (njëqind euro), në emër të shpenzime të procedurës penale shume prej 100€ (një qind euro), si dhe shumën prej 50€ (pesëdhjetë euro), në emër të kompensimit për viktimat e krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Konform neni 374 par. 3 lidhur me neni 62, dhe 69 të KPRK-së, i konfiskohet një pistoletë M- 57 kalibrit 7.62 x 25 mm, Zastava prodhim Jugosllav me nr. serik 208520 një karikator i zbrazet, një fishek i kalibrit 7.9 mm një fishekë i kalibrit 9x19 mm, të njëjtat pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit do të shkatërrohen.

Pas shpalljes të akuzuarit i është vazhduar paraburgimi deri në plotëfuqishmëri të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për krime të rënda, ka ngrit aktakuzë PP/I.nr.346/15 të datës 03.03.2016, ndaj të akuzuarit B. Q. nga fshati, Komuna, për vepër penale, “Grabitje në tentativë” nga neni 329 par.3 lidhur me neni 28 të KPRK-së, dhe për vepër penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim te pa autorizuar të armës nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Me aktgjykim të Gjykatës Themelore në Pejë P.nr.48/2016 te dt.30.06.2016 të akuzuarit B. Q. dhe A. Q. janë shpallë fajtor dhe janë gjykuar ashtu që B. Q. është gjykuar për vepër penale të grabitjes në tentativë nga neni 329 par. 3 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 vitesh dhe dënim me gjobë në shumën prej 300 €, për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve është caktuar dënim me gjobë në shumën prej 1000 €, ku dhe i është shqiptuar dënimi unik me burgim në shumën prej 1300 €. I akuzuari A. Q. është dënuar për vepër penale ndihmë në të grabitjes në tentativë nga neni 329 par. 3 lidhur me nenin 28 e lidhur me nenin 33 të KPRK-së dhe është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 15 muaj, si dhe janë obliguar në pagesën e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor.

Me rastin e shqyrtimit të ankesës së mbrojtësve dhe prokurores, gjykata e Apelit me aktgjykim PAKR nr. 560/2016, ka vendosur që çështja të kthehet ne rigjykim sa i përket te akuzuarit B. Q., me udhëzim se kjo çështje penale duhet te filloi rishtazi, ndërkaq për te akuzuarin A. Q. aktgjykimi është vërtetuar.

Në rigjykim të mbajtur me dt.22.02.2021 pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit PP/I.nr.346/15 të datës 03.03.2016, në seancën e shqyrtimit gjyqësor, gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe i të akuzuarit iu ka dhënë mundësinë që të deklarohen për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarin për rendësin dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe i akuzuari B. Q. ka deklaruar se pasi që i ka kuptuar pasojat dhe përparësit e pranimit të fajësisë të cilat i janë shpjeguar nga ana e gjykatës dhe pasi që është konsultuar paraprakisht me mbrojtësin, deklararon se e pranon fajësinë për dy veprat penale të cilat i vihen në barrë, pranimin e fajësisë e bënë vullnetarisht, pa presion nga askush.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë, meqenëse një pranim i tillë është i bazuar dhe i provuar edhe me provat në bazë të së cilës është ngritë aktakuza kështu që i propozon gjykatës që të njëjtën ta aprovoj, pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë për të dy veprat penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. I. O. ka deklaruar se gjithashtu pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit B. Q., me të njëjtin kanë pasur një bisedë, dhe e ka njoftuar për te gjitha favoret e pranimit të fajësisë.

Në vijim trupi gjykues duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarit vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të akuzuarit, pasi që ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

Duke pasur parasysh të lartcekurat trupi gjykues e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës konform nenit 253 të KPPK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 248 të KPPK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve dhe me shqiptimin e dënimit.

Prokurorja e shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet pranë fjalës përfundimtare në tërësi të deponuar në Gjykatë me shkrim me datë 30.06.2016, në shqyrtimin e kaluar e që është pjesë e shkresave të lendes, duke shtuar se pret nga Trupi Gjykues që me rastin e vendosjes lidhur me sanksionin penal, pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit të mos mbivlerësohet por të merret ashtu siç e kërkon ligjin. Te vlerësoi në relacion me të gjitha rrethanat tjera renduese siç janë: pjesëmarrja dhe kontributi në kryerjen e veprës penale nga ana e te njëjti mënyrën tejet të vrazhdë të kryerjes së kësaj vepre nga pika I e aktakuzës, motivet e ulëta të cilat është kryer kjo vepër, e sidomos shkaktimit të rrezikut të madh në këtë rast të dëmtuarin B. dhe dëshmitarin I. Q., mbi këto rrethana të merr një vendim të drejtë i cili do të ndikonte jo vetëm për të akuzuarin dhe sjelljen e tij në të ardhmen, por edhe si preventiv për të gjithë kryesit tjerë, sidomos kur jemi të vetëdijshëm për përhapjen e këtyre vepra në vend viteve të fundit.

I dëmtuari B. J. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se nga data 21.02.2021 janë pajtuar. Me familjen e këtu të akuzuarit janë miq pa asnjë kusht, dhe i vjen mirë se këtu i akuzuari e pranoi fajësisë dhe ndihet i penduar. Janë marrë vesh si familje dhe nëpërmjet këshillit të katundit, dhe nuk kanë asnjë kërkesë ndaj të akuzuarit e as kërkesë për dëmshpërblim.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. I. O. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se mbetet pjesërisht në fjalën përfundimtarë të shqyrtimit të kaluar, për faktin se i akuzuari B. Q., e pranoi fajësinë për veprat penale për te cilën pandehet pasi që me te njëjtin është konsultuar në kohë të mjaftueshme për një gjë të tillë, mendon se kjo e vërtetë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit do të perceptohet drejt nga ana e trupit Gjykues dhe Prokurorja e çështjes dhe përfundimit të elaboratit të rrethanave lehtësues në këtë çështje penale, të njëjtit ti shqiptohet një dënim me i butë në kuptim të dispozitave ligjore nga neni 73,74, 75, dhe 76 të KPRK-se, për faktin se i njëjti pos pranimit të fajësisë i njëjti shpreh keqardhje për veprat penale për te cilën pandehet, premtoi dhe i garanton Gjykatës se në të ardhmen nuk do te bije ndesh e as që do te kryej vepër tjetër penale. Për fat të mirë edhe tentimi i bërë ka mbetur pa u shkaktuar ndonjë pasoj po ashtu Gjykatën e lut që ti merr parasysh këto rrethana, moshën e tij kur është kryer vepra penale, po ashtu të merr parasysh se ka qene rasti i parë, dhe deri me tani nuk ka ndonjë vepër tjetër penale që e ka kryer, janë bashkëfshatarë, qysh e ceke përfaqësuesi i familjes së dëmtuar, kanë krijuar raporte miqësore, sikurse më parë, para ndodhjes së rastit konkret. I njëjti qe një kohë ka jetuar në Shtetin e, ka krijuar dokumentacion të rregullt, ka krijuar edhe familjen, dhe pas përfundimit te këtij proces gjyqësorë dhe obligimeve i njëjti mendon te kthehet në shtetin që është ekstraduar. Nga këto rrethana Gjykatës i propozoi që pas analizimit të këtyre rrethanat, te njëjti ti shqiptoj një dënim sa me të butë, ngase i njëjti ka qëndruar në Qendrën e paraburgimit në Pejë 7 muaj, ndërsa nga 1 marsi e deri më tani serish gjendet në paraburgim.

I akuzuari B. Q., në fjalën e tij përfundimtarë ka deklaruar se kërkon falje për gabimin qe e ka bërë ndaj familjes së dëmtuar, shpreh keqardhje dhe premtion qe në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla penale.

Gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike bazuar në pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit si dhe bazuar në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: raporti njoftues 2015-DC-538, 2015-HRP-113 i datës 02.12.2015, deklarata e të dëmtuarit e dhënë në polici me datë 01.12.2015 ajo e të pandehurave e dhënë po ashtu në polici me datë 01.12.2015, fotodokumentacioni, fletë kontrolla mjekësore nr.27740 e A. Q. e datës 04.03.1997, vërtetim mbi konfiskimin e përkohshëm të sendeve nr. 2015-DC-538 , 2015-HRP-113 e datës 02.12.2015, raporti i polici i datës 08.12.2015, 2015-DC-538, 2015-HRP-113, fotoalbumi me numër të njëjtë nga Njësia e Forenzikës, raporti i vendit të ngjarjes i dt.11.12.2015, raporti i ekzaminimit të veturës i datës 30.11.2015 në orën 23:15, vërtetimi mbi kthimin e sendeve i datës 08.12.2015, nr. 2015-DC-538, 2015-HRP-113, procesverbal i marrjes në pyetje të pandehurve në prokurori dhe ai i të dëmtuarit me datë si dhe dëshmitarëve me datë 28.01.2016, Ekspertiza Balistike AKF/2015-4441/2015-3603 dt.11.01.2016, deklarata e dëshmitarit P. I., P. Q. të dhënë në prokurori me dt.28.01.2016 si dhe shkresat e tjera të lëndës.

Nga të lartcekurat gjykata erdhi në përfundim se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementët e veprave

1.për veprën penale, “Grabitje në tentativë” nga neni 329 par.3 lidhur me neni 28 të KPRK-së, dhe

2. veprën penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armës nga neni 374 par.1 të KPRK-së,. I njëjti armën e kishte mbajtur në kundërshtim me nenin 5 të ligjit për armë Nr. 05/L -022 pasi që më parë nuk kishte siguruar leje për mbajtje.

Gjykata nuk ka gjetur se ekzistojnë rrethana për përjashtimin e përgjegjësisë penale të akuzuarit, andaj i akuzuari është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur mbi vendimin mbi dënimin konform nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin e dënimit Nga nga rrethanat lehtësuese gjeti se e kanë pranuar fajësinë qysh në fillim, për gjykatën nuk ka të dhëna se i njëjti më parë të ketë qenë i dënuar, janë pajtuar me palën e dëmtuar, është penduar dhe kërkon falje si dhe mungesën e pasojës. Ndërkaq nga rrethanat rënduese për të akuzuarin e lartcekur gjykata shkallen e larte të dashjes, ku i njëjti paraprakisht përgaditet duke vendosur pengesa në rrugë.

Për veprën e parë penale të grabitjes të e cekur si më lartë për të cilën i akuzuari është shpall fajtor minimumi i dënimit të paraparë është shtatë vite dhe maksimumi deri në dymbëdhjetë vite, mirëpo gjykata me rastin e vendosjes për dënimin ka aplikuar dispozitën e nenit 75 par.1 nën par.1.1,1.2 dhe 1.3 të KPRK-së për zbutjen e dënimit ashtu që të akuzuarit i shqiptoj dënim me burgim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi nën minimumin e paraparë ligjor, duke pas parasysh si rrethanë veçanërisht lehtësuese pranimin e fajësisë, mungesës së pasojës përkatësisht faktin se vepra ka mbetur në tentativë. Pasi që edhe dispozita e nenit 28 par.3 të KPRK-së parasheh që personi që tenton të kryej veprën penale dënohet sikur të kishte kryer veprën por që dënimi mund të zbutet.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të cekura si më lartë të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në

preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 41 të KRPK-së.

Konform nenit 374 par. 3 lidhur me nenin 62, dhe 69 të KPRK-së, i konfiskohet një pistoletë M-57 kalibrit 7.62 x 25 mm, Zastava prodhim Jugosllav me nr. serik 208520 një karikator i zbrazet, një fishek i kalibrit 7.9 mm një fishekë i kalibrit 9x19 mm, të njëjtat pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimit do të shkatërrohen.

Konform nenit 83 të KPRK-së gjykata të akuzuarit i ka llogaritur paraburgimin në dënimin e shqiptuar.

Arsyet për vazhdimin e paraburgimit pas shpalljes së aktgjykimit gjykata i ka dhënë në aktvendimin e veçantë PKR.nr.54/17 të dt.22.02.2021.

I dëmtuari B. J. në shqyrtim gjyqësor deklaroj se nuk ka kërkesë për dëmshpërblim.

Duke u bazuar në nenin 450 të KPPRK-së, e obligoi të akuzuarin në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor.

Konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit i obligoi të akuzuarin që të paguaj shpenzimet e viktimave të krimit.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA,**

2018:032784, 05.03.2021

Kryetarja e trupit gjykues

Violeta Husaj Rugova

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.